REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 125/17
Data/Datum 09.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 125/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej: Goran Milenkoviç - Kryetar, z.Ekrem Salihu – Anëtar, z.Nuhi Paçarizi – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE NT "Biti Com" - me seli në Podujevë, kundër Njoftimit për për dhënien e kontratës të datës 31.03.2017, nga ana e autoritetit kontraktues (AK) – KK Obiliq, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ", me nr. prokurimi: OB/614/17/574/121, me datë: 23.05.2017 mori këtë :

V E N D I M
MBI APROVIMIN TË ANKESËS SË OE "BITI COM" – PODUJEVË, TË DATËS: 21.04.2017.

I. <u>Aprovohet si e bazuar</u>, ankesat OE "Biti Com", me seli në Podujev, kundër Njoftimit për dhënien e kontratës të dates 31.03.2017, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: "Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ", me nr. prokurimi: OB/614/17/574/121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Obiliq.

II. <u>Anulohet,</u> vendimi i Autoritetit Kontraktues (AK) – KK Obiliq, Njoftimi për dhënien e kontrates, lidhur me procedurën e prokurimit me titull "Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ", me nr. prokurimi: OB/614/17/574/121, si i pa-bazuar, dhe njëherit urdhërohet Autoriteti kontraktues që këtë aktivitet të prokurimit të kthej në **Ri-vlerësim.**

III. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konformë dispozitave

ligjore të nenit 131 të LPP-së Nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues, që nuk respekton vendimin e Panelit shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

IV. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

V. Meqenëse pretendimet ankimore të operatoreve ekonomik ankues "Biti Com" – janë të qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, të njejtit i kthehet sigurimi i ankesës.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik "Biti Com" - Podujev, si palë e pa-kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt: 21.04.2017, kundër Njoftimit për dhënien e kontrates të datës 31.03.2017, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të ligjit për TVSH, nr.04/L-163, konkretisht jemi eliminuar padrejtësisht.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113.1 të LPP-së Nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të pales ankimore, të OE "**Biti Com**" , me seli në Podujevë.

Eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor se i njëjti pretendim ankimor është i bazuar duke u bazuar në atë se Autoriteti kontraktues është i obliguar **korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.**
Citim: interpretimi i KRPP-së të publikuar në pyetje dhe përgjigjje nr.46, citojmë: "si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Eksperti shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues me rastin e eliminimit të OE ankues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së, për faktin se në rastin konkret AK-ja është dashur të bëjë kalkulimin e TVSH-së, apo të verifikoj se për të njëjtit produkte a bëjnë pjesë në TVSH, sepse OE ankues ka ofruar një listë me të cilen dëshmon se të njëjtit artikuj janë të liruar nga TVSH-ja, njëherit Eksperti shqyrtues i rekomandon AK-së që të verifikoj gjatë ri-vlerësimit se për të njëjtit artikuj a kërkohet TVSH.

Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e lartë cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – KK MAMUSHË, për këtë aktivitet të prokurimit "Furnizim me traktor per pastrimin e rrugëve të Mamushës", me nr. të Prokurimit: 626/16/040/121, NUK i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, siç janë konkretisht neni 7 dhe 28 i LPP-së, prandaj

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të BAZUARA ankesën OE "BITI-COM", me seli në Podujev, dhe njëherit të ANULOJ vendimin "Njoftimi për dhënien e kontratës, i datës 28.03.2017, ndërsa ky aktivitet i prokurimit të kthehet në RI-VLERËSIM, për këtë aktivitet të prokurimit: "Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ", me nr. prokurimi: OB/614/17/574/121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Obiliq.

Me datë 05.05.2017, OE ankues përmes parashtresës me shkrim informon OSHP, se pajtohet me raportin ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues me datë 08.05.2017, përmes parashtresës me shkrim informon OSHP, se NUK pajtohet me raportin ekspertit shqyrtues.

Në seancen e dt.23.05.2017, të mbajtur në OSHP. Kryetari i panelit hapi seancën e shqyrtimit kryesorë të ankesës në ora 09.30, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit OE, përfaqësuesi i AK-së, si dhe eksperti shqyrtues.

Në vazhdim të seances kryetari i panelit fjalen iu dha përfaqësuesit të OE:"Biti Com" z. Kaçiu i cili deklaroj: "Arsyetimi i AK për TVSH , ne e dimë ato që kemi të ofruar janë të liruara nga TVSH andaj nuk kemi vendosur TVSH 18%, kjo nuk është bërë sipas dëshirës tonë por këto dalin nga ligjet e Kosovës. AK-ja na ka thënë se kjo është arsyeja e vetme për eliminimin tonë. Andaj edhe kemi parshtruar ankesë në OSHP dhe eksperti poashtu ka kosntatuar se jemi elminuar padrejtësisht. I rekomandojmë panelit të aprovoj ankesën tonë si të bazuar".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-KK Obiliq z. Hoti i cili deklaroj:

Ne kemi dhënë me shkrim sqarimet tona edhe në përgjigje të raportit të ekspertizës ku kemi kundërshtuar këtë raport.

Ne kemi lexuar edhe kërkesën në KRPP për interpretim ligjorë dhe mendoj se varet nga kërkesa edhe interpretimi. Në bazë të interpetimit të KRPP thuhet se TVSH mund të përmirësohet nëse ka gabime më shumë ose më pak. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me gabime por me mosplotësim fare të TVSH-së. Kjo ka dallim shumë të madh nëse OE ka dhën 16% në vend të TVSH këtu mund të bëhet përmirësim, mirëpo OE ankues nuk ka plotësuar fare pjesën e dytë te përshkrimit të çmimit. Ndoshta ka qenë e metë që nuk kemi bërë me shkrim pranë KRPP, mirëpo në konsultim me tavolinë ndihmëse, dhe nëse te platforma e elektronike nuk japim çmim te TVSH, sistemi jep rezultatin 0 në total.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z. Fazliu i cili deklaroj:

"sa i përket intepretimit të KRPP pyetje numër 46 lidhur me TVSH, se si të veprohet kur një OE normën e TVSH të përcaktuar me ligjin e TVSH për një ose më shumë artikuj, në ofertën e tij vendos gabimisht, jo në bazë të normës së përcaktuar me ligj mbi TVSH, AK-ja është e obliguar të korrigjoj apo të vendos TVSH për ato artikuj në bazë të normave të TVSH të aplikueshme pa pas nevoj për sqarime prej OE, pasi dihet se TVSH përcaktohet me normë fikse. Mirëpo në rastin konkret kemi të bëjmë me produkte bujqësore të cilat janë të liruara nga TVSH dhe për të cilat AK-ja gjatë vlerësimit duhet të marr informacione të sakta prej doganave për këto produkte. AK-ja thirret në pjesën A pika 1, mirëpo kjo është për tatim doganor, dhe nuk ka të bëjë fare me TVSH pasi TVSH është diqka krejt tjetër".

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në shkresat e lëndes, raportin e ekspertit shqyrtues, të datës 03.05.2017, **konstaton** se ankesa e OE. ankues është e bazuar, për faktin se Autoriteti kontraktues KK Obiliq në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së ka vlerësuar aktivitetin e prokurimit, duke duke mos marrur masa për të siguruar se produktet e kërkuar për këtë aktivitet të prokurimit a bëjnë pjesë në TVSH, poashtu Autoriteti kontraktues është i obliguar që të përmisoj TVSH në ofertën financiare apo të vendos TVSH, kur e njëjta mungon në çmimet e ofertës financiare, duke u bazuar në interpretimin e KRPP-së, pyetja nr.46 në ëeb-site e KRPP-së.

Andaj, paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin:117 të LPP-së dhe atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mundë të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesëpadi në Departamentin për çështje administrativ
pranë Gjykatës Themelore.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenkovic

Vendimi t'i dorëzohet:
1. 1x1 AK – "KK OBILIQ".
2. 1x1 OE "BITI COM".
3. 1x1 Arhivës së OSHP-së